Zerat e përfshirë në pasqyrat financiare të Shoqërisë maten duke përdorur monedhën e mjedisit kryesor ekonomik në të cilin entiteti operon (monedha funksionale). Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lekë, e cila është monedha e prezantimit të Shoqërisë.

Transaksionet dhe gjendjet

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të Shoqërisë, transaksionet në monedha të ndryshme krahasuar me monedhën funksionale të Shoqërisë (monedhat e huaja) regjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në çdo datë të Bilancit Kontabel, aktivet dhe detyrimet monetare që janë në monedha të huaja përkthehen me kursin zyrtar të këmbimit të datës së Bilancit Kontabel. Diferencat nga këmbimi njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën lindin. Aktivet dhe detyrimet jomonetare që janë njohur me kosto historike në monedhë të huaja përkthehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet në monedha të huaja dhe që janë paraqitur me vlerë të drejte përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën që është përcaktuar vlera e drejte.

Monedhat e huaja me të cilat operon Shoqëria janë Euro dhe USD (dollari amerikan). Kursi i këmbimit zyrtar i Bankes së Shqipërisë (Leku kundrejt njësive të monedhave të huaja) për monedhat kryesore më 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Dollari amerikan (USD)	125.79	115.23
Euro (Euro)	137.28	140.14

b) Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitime ekonomike do të hyjnë në Shoqëri në të ardhmen, dhe që të ardhurat mund të maten në mënyrë të besueshme. Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja njihen kur i janë kaluar blerësit të

gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit.

Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose zbritjet e ofruara. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tremeve dhe kur realizohen të ardhurat për të cilat janë kryer keto shpenzime.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ato ndodhin sipas parimit të drejtave të konstatuara dhe kontabilitetit rrjedhes

c) Tatimet

Tatimi mbi fitimin

Aktiviteti dhe detyrimet për tatimin mbi fitimin për periudhën aktuale maten me shumën e pritura për të marrë nga apo për të paguar tek organet tatimore. Norma e tatimit dhe ligjet për tatimet të përdorura për llogaritjen e vlerës së tatimit fitimit, janë ato të nxjerra ose të publikuara në datën e raportimit në Shqipëri, ku Shoqëria operon dhe siguron të ardhura të tatueshme.

Tatim mbi fitimin aktual që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital njihet në kapital dhe jo në pasqyrën e të ardhurave. Drejtimi vlerëson në mënyrë periodike pozicionet e ndërmarrja në formularët e deklarimit të pagesave në lidhje me situatën në të cilat rregulloret e aplikueshme për tatimet janë subjekt i interpretimeve, si dhe një provizion nëse është e përshtatshme.

Tatim fitimi llogaritet me 15% (31.12.15: 15%) mbi fitimin e tatueshem.

Tatimi fitimi i shtyre

Shoqëria nuk ka zgjedhur të zbatojë standartin SKK 11 për sa i përket njohjes së Tatimit fitimit të shtyre.

d) Aktive afatgjata materiale

Aktiviteti afatgjatë materiale paraqiten me kosto, duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe/ose nëse ka humbje të rënies së vlerës. Në tilla kosto përfshihen kostot e zëvendësimit të një pjese të aktiveve afatgjata materiale dhe kostot e huase për projektet afatgjata nëse plotësohen kriteret e njohjes. Kur pjesë të rendesishme të aktiveve afatgjata materiale nevojiten të zëvendësohen në intervale, Shoqëria i njeh keto pjesë si aktive të vecanta me vlerë të dobishme specifike dhe i zhvlerëson ato në përputhje me rrethanat. Në të njëjtën mënyrë, kur kryhet një inspektim i madh, kosto e tij njihet në vlerën e mbartur të aktivitetit afatgjatë material si një zëvendësim nëse plotësohet kriteri i njohjes. Të gjitha riparimet e tjera dhe kostot e mirëmbajtjes njihen në pasqyrën e të ardhurave kur ndodhin.

Vlera kontabel e aktiveve afatgjata materiale rishikohet për rënie në vlerë kur ndryshimet e rrethanave tregojnë që vlera kontabel mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëq.s rrethanat të tilla ekzistojnë dhe kur vlera kontabel tejkalon vlerën neto të realizueshme, aktiviteti ose njesitë gjeneruese të parave do të pakesohen në vlerën e tyre të realizueshme dhe humbjet nga rënia e vlerës njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Amortizimi llogaritet me metodën e vlerës së mbetur të aktiveve si më poshtë:

Ndertesat	5%
Mjete transporti	20%
Makinë dhe pajisje	20%

Një zë i aktiveve afatgjata materiale si dhe ndonjë pjesë e rendesishme e njohur fillimisht, rregjistrohet me daljen jashtë përdorimi të saj ose kur nuk pritet të sigurohen përfitime ekonomike të ardhshme nga

perdorimi apo nxjerrja jashte perdorimit. Cdo fitim apo humbje qe realizohet nga dalja jashte perdorimit e aktivit (llogaritur si ndryshimi ndermjet te hyrave neto nga dalja jashte perdorimit dhe vlera e mbartur e aktivit) perfshihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivi cregjistrohet.

Vlerat e rikuperueshme e aktivit, jeta e dobishme dhe metodat e zhvleresimit rishikohen cdo fund viti financiar dhe rregullohen nese eshte e domosdoshme ne menyre prospektive.

e) Aktivet dhe detyrimet financiare

i) Aktivet financiare

Aktivitet financiare konsistojne teresisht ne llogari te arketueshme dhe te tjera te arketueshme dhe jane pasqyruar ne Bilancin Kontabel bazuar ne shumet e faturuara. Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në Bilancin Kontabel me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen e vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër). Provizione për llogaritë e arketueshme nuk janë llogaritur pasi është gjykuar që ekziston një siguri që të drejtat nga klientet do të arketohen.

Crrgjistrimi

Një aktiv financiar (ose ku është e mundur pjesë e aktivitet financiar apo grup aktivesh financiare të ngjashme) cregjistrohet kur:

- ✓ Te drejtat për të siguruar flukse monetare nga aktivi kanë perfunduar
- ✓ Shoqëria ka transferuar të drejtat e saj për të siguruar flukse monetare nga aktivi ose ka supozuar një detyrim për të paguar flukset monetare të mara në teresi, pa vonesa materiale një pale të tretë nepermjet një marreveshjeje; dhe ose
 - (a) Shoqëria ka transferuar në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivitet ose
 - (b) Shoqëria as nuk ka transferuar dhe as ka mbajtur në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivitet, por ka transferuar kontrollin e aktivitet.

Kur Shoqëria ka transferuar në mënyrë thelbësore të drejtat e saj për të siguruar flukse monetare nga një aktiv ose ka hyrë në një marreveshje; ajo vlerëson nëse dhe në çfarë mase ka mbajtur rreziqet dhe perfitimet e pronësive. Kur as nuk ka transferuar dhe as nuk ka mbajtur në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivitet, nuk ka transferuar as kontrollin e aktivitet, aktivi do njihet në masën e përfshirjes së vazhdueshme të Shoqërisë në aktiv. Në këtë rast, Shoqëria njeh gjithashtu një detyrim të lidhur. Aktivi i transferuar dhe detyrimi i lidhur maten në bazën që reflekton të drejtat dhe detyrimet që Shoqëria ka marrë përse. Përfshirja e vazhdueshme që merr formën e garancisë mbi aktivin e transferuar matet me të voglen ndërmjet vlerës origjinale të mbartur të aktivitet dhe vlerës maksimale të konsideratës që Shoqëria mund të jetë e detyruar të ripaguajë.

ii) Renia në vlerë e aktiveve financiare

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit, nëse ka evidence objektive që një aktiv financiar apo grup aktivesh ka pësuar rënie vlerë. Një aktiv financiar apo një grup aktivesh financiar konsiderohet i zhvlerësuar vetëm nëse ka evidence objektive për zhvlerësimin si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të një aktivi (një "ngjarje humbjeje" e ndodhur) dhe kjo ngjarje humbjeje ka pasur ndikim mbi flukset monetare të ardhshme të vlerësuar të aktivitet financiar apo grupit të aktiveve financiare dhe që mund të matet në mënyrë të besueshme. Evidence e zhvlerësimit mund të përfshijë tregues që debitoret apo grup debitorësh mund të jenë duke përjetuar probleme të mëdha

financiare, mospagesa ne kohe te principalit apo interesit, probabiliteti qe ata te kalojne ne falimentim ose nje riorganizim tjeter financiar dhe kur te dhenat e vëzhgueshme tregojne se ka nje renie te matshme te flukseve monetare te ardhshme te parashikuara, te tilla si ndryshime ne fusha dhe kushtet ekonomike qe jane ne korrelacion me vonesat.

iii) Detyrimet financiare

Detyrimet financiare konsistojne teresisht ne llogari te pagueshme dhe te tjera te pagueshme jane pasqyruar ne Bilancin Kontabel bazuar ne shumat e faturuara. Detyrimet afatgjata dhe afatshkurtra, jane llogaritur me kosto, dhe jane detajuar me poshte. Gjithashtu ne detyrimet afatgjata jane paraqitur dhe disa kontribute te ortakeve te cilat jane bere per te financuar zhvillimin e aktivitetit.

f) Inventaret

Inventaret jane paraqitur me vleren me te ulet midis koston dhe vleres neto te realizueshme. Kosto perbehet nga materialet direkte dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme, koston e punes direkte dhe ato kosto te pergjithshme qe kane ndodhur per te sjelle inventarin ne vendin dhe kushtet aktuale te magazinimit. Kosto eshte llogaritur duke perdorur metoden e koston mesatare per mallrat. Vlera neto e realizueshme perfaqeson cmimin e vleresuar te shitjes minus koston e vleresuar te perfundimit dhe koston e marketingut, shitjes dhe shperndarjes. Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me vleren neto te realizueshme.

g) Mjetet monetare

Mjetet monetare ne Bilancin Kontabel perfshijne mjetet monetare ne banke ne dhe ne arke ne Leke dhe ne monedha te huaja dhe depozitat ne te pare me nje maturitet deri ne 3 muaj. Per qellime te pasqyres se flukseve te mjeteve monetare Mjetet monetare perfshijne sa me siper.

h) Detyrimet per sigurimet shoqerore

Shoqeria pagan vetem kontributet per sigurimet e detyrueshme shoqerore qe sigurojne pension per punonjesit. Qeveria shqiptare eshte pergjegjese per caktimin e minimumit te kontributit per sigurimet shoqerore ne Shqiperi sipas nje plani pensioni bazuar ne kontribute. Kontributet e shoqerise ne planin e pensionit jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

i) Angazhime dhe detyrime te kushtezuara

Detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato jepen ne formen e shenimeve shpjeguese pervec rasteve kur eshte e sigurte qe do kete nje fluks dales burimesh qe mbartin perfitime ekonomike. Nje aktiv i kushtezuar nuk njihet ne pasqyrat financiare por vetem jepet ne formen e shenimeve shpjeguese kur pritet te kete nje fluks hyres perfitimesh ekonomike. Vlera e nje humbje te kushtezuar njihet si provizion nese ka mundesi qe ngjarje te ardhshme do te konfirmohen, nje detyrim do te haset ne daten e Bilancit Kontabel dhe mund te behet nje vleresim i arsyeshem i shumes se humbjes.

j) Transaksionet me palet e lidhura

Pale te lidhura jane ato, kur njera prej paleve kontrollohet nga pala tjeter ose ka influence te rendesishme ne vendimarrjen financiare ose te biznesit te pales tjeter. Per qellim te shpalosjes ne pasqyrat financiare, vetem ortaku i Shoqerise do te konsiderohet pale e lidhur.

k) Ngjarje pas dates se bilancit

Ngjarjet pas dates se bilancit qe permbajne informacion shtese per pozicionin e Shoqerise, ne daten e Bilancit Kontabel (ngjarjet rregulluese) jane reflektuar ne pasqyrat financiare. Ngjarjet pas bilancit qe

nuk janë ngjarje rregulluese paraqiten të shpalosura në shenimet shpjeguese të pasqyrave financiare kur janë materiale.

II. Shenimet që shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare.

Bilanci kontabel, Aktivët

1. Aktivët monetarë

Vlera e aktiveve monetare më 31.12.2015 është 12,122,707 lekë.

Nr	Likuiditete	Viti 2015	Viti 2014
1	Depozita në bankë	26,542	1,426,539
2	Para në arke	12,096,165	5,530,207
	Totali	<u>12,122,707</u>	<u>6,956,746</u>

Depozitat në monedha të huaja janë konvertuar me kursin e datës 31.12.2015 të Bankës të Shqipërisë dhe diferencat janë kontabilizuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2. Te drejta të arketueshme

Në këtë post paraqiten të drejta të arketueshme më 31.12.2015 në shumën 31,769,003 lekë, si më poshtë:

Nr	Te drejta të arketueshme	Viti 2015	Viti 2014
1	Kliente	31,431,069	39,235,693
2	Tvsh	143,886	34,724
3	Tatim fitimi	194,048	502,115
	Totali	<u>31,769,003</u>	<u>39,772,532</u>

3. Inventaret

Paraqitet gjendja e medikamenteve të pa shitura më 31.12.2015, në shumën 14,364,100 lekë.

Nr	Gjendje inventari	Viti 2015	Viti 2014
1	Medikamente	14,364,100	26,815,527
	Totali	<u>14,364,100</u>	<u>26,815,527</u>

- ❖ Vlerësimi i mallrave në momentin e blerjes është bërë me koston e hyrjes veprimet e daljes e të gjendjeve të inventarit janë bërë me kosto mesatare e cila nuk ka ndryshuar në vite.
- ❖ Të gjitha transaksionet e kryera si blerje, shitje, kalim në llogarite e shpenzimeve vjetore i përkasin ushtrimit kontabel të vitit 2015.

4. Shpenzimet e shtyra

Paraqiten shpenzime për siguracionet e mjeteve të cilat i përkasin periudhave të ardhshme në shumën 49,931 lekë.

Nr	Shpenzime të shtyra	Viti 2015	Viti 2014
1	Shpenzime për siguracione	49,931	48,213
	Totali	<u>49,931</u>	<u>48,213</u>

5. Aktivët afatgjatë

Vlera kontabel e aktiveve afat gjatë materiale në datë 31.12.2015 është 5,875,371 lekë.

Gjendja e tyre paraqitet si më poshtë:

Nr	Emertimi	Ndertesa	Mjete transporti	Pajisje Zyre	Totali
	Aktive të qëndueshme të				
I	trupëzuar				
1	Gjendja më 31.12.2014	2,661,280	10,727,446	1,611,044	14,999,770
2	Shtesat për 2015			35,000	35,000
3	Paksimet për 2015				
4	Gjendja më 31.12.2015	<u>2,661,280</u>	<u>10,727,446</u>	<u>1,646,044</u>	<u>15,034,770</u>
II	Amortizimi I AQT-ve				
1	Gjendja më 31.12.2014	398,378	6,258,463	951,293	7,608,134
2	Shtesat për 2015	113,145	1,295,579	142,541	1,551,265
3	Paksimet për 2015				-
4	Gjendja më 31.12.2015	<u>511,523</u>	<u>7,554,042</u>	<u>1,093,834</u>	<u>9,159,399</u>
III	Vlera neto 31.12.2015	<u>2,149,757</u>	<u>3,173,404</u>	<u>552,210</u>	<u>5,875,371</u>

Si politikë kontabel për kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vlerësimi fillestar në momentin e hyrjes është bërë me koston dhe në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvlerësimin e akumuluar dhe ndonjë humbje nga renia e vlerës. Drejtimi nuk ka llogaritur renie të vlerës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015 dhe 31 Dhjetor 2014.

Bilanci kontabel, Pasivët

6. Detyrimet Afatshkurtra

Në këtë post paraqitet gjendja e detyrimeve afatshkurtra më 31.12.2015 në shumën 25,913,543 lekë.

Nr	Detyrimet afatshkurtra	Viti 2015	Viti 2014
1	Titujt e huamarrjes	5,200,135	9,069,164
2	Detyrime për furnitorë	20,402,920	37,000,105
3	Të pagueshme ndaj punonjësve	46,330	-
4	Të pagueshme për detyrimet tatimore	246,659	257,088
5	Të pagueshme të tjera	17,499	11,311
	Totali i detyrimeve	<u>25,913,543</u>	<u>46,337,668</u>

6.1 Titujt e huamarrjes

Paraqitet detyrimi për overdraft të marrë në BKT, i palikujduar deri më 31.12.2015 për 5,200,135 lekë.

6.2 Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Paraqitet gjendja e furnitorëve të palikujduar deri më 31.12.2015 për 20,402,920 lekë.

6.3 Të pagueshme ndaj punonjësve

Paraqitet detyrim për paga të palikujduara deri më 31.12.2015 për 46,330 lekë.

6.4 Të pagueshme për detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore të shoqërisë me 31.12.2015 paraqiten në shumën 246,659 lekë, të detajuara si më poshtë:

Nr	Detyrimet tatimore	Viti 2015	Viti 2014
1	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	63,743	64,172
2	Tatimi mbi të ardhurat personale	3,900	3,900
3	Tatim qeraje	-	10,000
4	Gjoka e penalitete	179,016	179,016
	Totali i detyrimeve	<u>246,659</u>	<u>257,088</u>

6.5 Të pagueshme të tjera

Paraqitet shuma prej 17,499 lekë, e cila përfaqëson detyrime për kalim të gabuar në llogarinë bankare të shoqërisë.

7. Kapitali

Kapitalet e veta janë shtuar me fitimin e vitit 2015 në shumën 3,620,605 lekë.

Gjendja e tyre me 31.12.2015 është 38,267,570 lekë, e detajuar sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emertimi	Kapitali I nenshkruar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitimi i vitit	Totali
1	Gjendja me 31.12.2014	18,000,000	1,622,029	12,600,000	2,424,936	34,646,965
2	Shtesat për 2015	-	-	2,424,936	3,620,605	6,045,541
3	Paksimet për 2015	-	-	-	(2,424,936)	(2,424,936)
4	Gjendja me 31.12.2015	<u>18,000,000</u>	<u>1,622,029</u>	<u>15,024,936</u>	<u>3,620,605</u>	<u>38,267,570</u>

C. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

8. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i shoqërisë nga shitja e medikamenteve për vitin 2015 janë 43,928,294 lekë.

Nr	Emertimi	Viti 2015	Viti 2014
1	Të ardhura nga shitja e medikamenteve	43,928,294	97,256,215
	Totali i të ardhurave	<u>43,928,294</u>	<u>97,256,215</u>

9. Lende e pare dhe materialet e konsumueshme

Tek ky post janë përfshirë shpenzimet për koston e medikamenteve të shitura për vitin 2015, në shumën 32,183,966 lekë, si më poshtë:

Nr	Emertimi	Viti 2014	Viti 2014
1	Blerje medikamente	19,081,717	88,078,247
2	Ndryshimi i gjendjes	12,451,427	-6,591,679
	Shuma I	<u>31,533,144</u>	<u>81,486,568</u>

Te tjera shpenzime			
1	Pullat e takses	59,709	-
2	Blerje ambalazhi	5,220	-
3	Sherbim skanimit doganor	3,813	-
4	Blerje karburanti	582,080	-
Shuma II		<u>650,822</u>	-
Totali		<u>32,183,966</u>	<u>81,486,568</u>

10. Shpenzime personeli

Kosto e punes eshte ne shumen 3,223,500 leke si me poshte :

Nr	Kosto e Punes	Viti 2015	Viti 2014
1	Shpenzime per paga	2,762,210	4,387,445
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	461,290	732,704
Shuma		<u>3,223,500</u>	<u>5,120,149</u>

11. Shpenzime konsumi dhe Amortizimi

Shoqeria ka llogaritur amortizimin e aktiveve per vitin 2015, sipas normave ligjore ne fuqi ne shumen 1,551,265 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2015	Viti 2014
1	Amortizim asetesh	1,551,265	1,101,525
Shuma		<u>1,551,265</u>	<u>1,101,525</u>

12. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Tek shpenzimet e tjera per vitin ushtrimor 2015 ne shumen 1,916,263 leke jane perfshire :

Nr	Emertimi	Viti 2015	Viti 2014
1	Personel i jashtem	136,200	150,000
2	Telefon	172,828	336,308
3	Mirembajtje e riparime	104,543	198,707
4	Kancelari	-	97,700
5	Sigurime	136,320	77,303
6	Sherbim roje	10,000	120,000
7	Transport	371,624	678,144
8	Qira	300,000	1,200,000
9	Energji	-	132,658
10	Sherbime bankare	96,527	-
11	Taksa vendore	47,120	-
12	Te tjera	40,401	-
13	Karburant	-	791,050
14	Dieta per personelin	500,700	480,000
Shuma		<u>1,916,263</u>	<u>4,261,870</u>

13. Shpenzime financiare

Jane paraqitur shpenzime per shumen 746,290 leke, te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2015	Viti 2014
1	Shpenzime per interesa leasing, overdrafti	248,589	585,865
2	Te ardhura nga interesa bankare	(243)	-
3	Fitimi nga kembimet valutore	(1,078)	-
4	Taksa te tjera	-	6,960
5	Pulla te barnave	-	54,469
6	Taksa lokale	-	74,000
7	Sherbime bankare	-	157,759
	Shuma I	247,268	879,053
1	Humbje nga kembimet valutore	230,000	505,490
	Shuma II	230,000	505,490
1	Takse pasurie	77,906	-
2	Gjoha e penalitete	56,360	682,556
3	Shpenzime per kredi (BKT)	-	19,200
4	Blerje pa fature te rregullt tatimore	134,756	-
5	Humbje nga mosarketimi klientit	-	169,735
6	Shuma III	269,022	871,491
	Totali I detyrimeve	746,290	2,256,034

14. Llogaritja e rezultatit

Nr	EMERTIMI	VITI 2015	VITI 2014
1	Te ardhura	43,928,294	97,256,215
2	Shpenzime	(39,621,284)	(94,226,146)
3	Rezultati	4,307,010	3,030,069
4	Shpenzime te pa zbritshme	269,022	1,004,149
	a- gjoha e penalitete	56,360	871,491
	b-fature jo e rregullt tatimore	134,756	132,658
	c-takse pasurie	77,906	-
5	Rezultati per llog.e tatimit	4,576,032	4,034,218
6	Tatimi i fitimit	686,405	605,133
7	Fitimi i vitit ushtrimor	3,620,605	2,424,936

Per vitin ushtrimor 2015 shoqeria paraqitet me nje fitim neto prej 3,620,605 leke. Shpenzimet e pazbritshme ne shumen 269,022 leke.

III -Shenime te tjera

Ngjarje te ndodhura pas dates se bilancit per te cilat behen rregullime apo ngjarje te ndodhura pas dates se bilancit per te cilat nuk behen rregullime nuk ka.

Gabime materiale te ndodhura ne periudhat kontabel te meparshme te konstatuara gjate periudhes raportuese nuk ka.

Administrator i shoqerise

Muharrem Yziri

Hartuesi

Artela Terthorja

R A P O R T I
I
AUDITUESES SE PAVARUR

Mbi modalitetet e bashkimit nëpërmjet përthithjes të shoqërive

“CFO PHARMA”sh.p.k.
dhe
“OMEGA PHARMA GROUP”sh.p.k.

PERMBAJTJA.....	2
I- OPINIONI I AUDITUESIT	3-5
II- TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SHOQËRINË	6
III- PROCEDURAT E ANGAZHIMIT	7-11
IV- METODAT E PERDORURA PER BASHKIMIN E DY SHOQERIVE	11
V- PROJEKTI I BASHKIMIT.....	7-11
VI- VEPRIMET KONTABILE PER PARAQITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE TE SHOQERISE "CFO PHARMA" shpk (shoqeria perthithese).....	12
VII-PASQYRAT FINANCIARE PAS BASHKIMIT	13-16
VIII -FUNKSIONI I SHOQERISE PERTHITHESE	17
IX-KONKLUZIONE PERFUNDIMTARE.....	18

I. OPINIONI I AUDITUESES

Une, Shpresa Breçani, me profesion Audituese e Pavarur me license profesionale Nr.143, date 29.06.2005 leshuar nga IEKA, jam caktuar Eksperte per te kryer misionin e bashkimit te shoqerive "CFO PHARMA" shpk me "OMEGA PHARMA GROUP" nepermjet perthithjes, sipas Vendimit te Asamblese se Ortakut te vetem date 24/10/2016 te shoqërisë "CFO PHARMA" shpk (shoqeria perthithese) dhe Vendimit te Asamblese se Ortakut te vetem, date 24/10/2016 te shoqërisë "OMEGA PHARMA GROUP" shpk (shoqeria e perthithur).

Qellimi i Anagazhimit:

Ne zbatim te Vendimit te Asamblese se ortakeve te te dyja shoqerive qe bashkohen Une kam realizuar angazhimin tim ne perputhje me Standardin Nderkombetar te Dheniese se Sigurise 3000.

Ky Standad kerkon qe une te planifikoj dhe te kryej procedurat ne menyre qe te arrij nje nivel te arsyeshem sigurie.

Baza ligjore per kryerjen e ketij misioni.

- 1.Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare".
- 2.Ligji Nr.9723, date 03.05.2007 " Per QKR-ne".
- 3.Vendimet e Ortakeve te Shoqerise "OMEGA PHARMA GROUP" shpk dhe "CFO PHARMA" shpk.
- 4.Bilancet kontabel te 3 viteve te fundit per te dy shoqerite si dhe bilanci i 9-mujorit i te dyja shoqerive.

Per kryerjen e ketij misioni une kam verifikuar sa me poshte:

- 1.Projektet e bashkimit nepermjet perthithjes date 24/10/2016 te te dyja shoqerive;
- 2.Pasqyrat financiare te 9 mujorit te te dy shoqerive subjekt bashkimi;
- 3.Llogaritjen e Raporteve te kuotave ne shoqerine perthithese pas bashkimit;



Pergjegjesite e Drejtimet per Projektin e Bashkimit

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte ne perputhje me kerkesat ligjore te: deklarimeve financiare, juridike dhe e informacioneve te tjera te domosdoshme per dhenien e sigurise se procesit bashkimit me perthithje.

Drejtimi eshte gjithashtu pergjegjes te ndermarre ne kohe te gjitha veprimet e nevojshme per realizimin e procesit te bashkimit me perthithje, te dorezimit te dokumentacionit prane QKR-se dhe ne njoftimin paleve te interesuara per procesin e bashkimit me perthithje te dy shoqerive, njoftimin e autoriteteve tatimore per procedurat e bashkimit me perthithje, si dhe njoftimin prane Autoritetit te Konkurrences ne zbatim te Ligjit Nr. 9121, date 28.7.2003 "Per mbrojtjen e konkurrencës", neni 10 "Perqendrimet e ndermarrjeve", nese kjo eshte e nevojshme. Drejtimi ka pergjegjesine te garantoje se nuk eshte i perfshire ne ndonje proces falimentimi apo likuidimi. Drejtimi eshte pergjegjes per vertetesine e gjendjes se aktiveve te shoqerise te tille qe, nese vendimi bashkimit e dy shoqerive do te ishte marre ne daten e aplikimit per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, bashkimi do te ishte ende i mundur.

Pergjegjesia e Ekspertes Kontabel te Regjistruar

Pergjegjesia ime eshte te jap nje opinion mbi sigurine e procesit bazuar ne verifikimin e procedurave, te metodave te perdoruara per te arritur bashkimit me perthithje te te dy shoqerive, si dhe pershtatshmerine e perdorimit te ketyre metodave.

Une besoj se te dhënat që kam siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin per vleresimin e modaliteteve te bashkimit me perthithje te dy shoqerive si dhe raportin e kembimit te kuotave.

Opinion

Sipas opinionit tim, procedurat e bashkimit me perthithje te dy shoqerive "CFO PHARMA" shpk dhe "OMEGA PHARMA GROUP" shpk paraqesin te dhena te plota dhe te nevojshme per realizimin e procesit te bashkimit te tyre.

Raporti i kembimit eshte i sakte dhe nuk cenon barazine e ketyre kuotave te dy shoqerive. Procesi i Bashkimit me perthithje te dy shoqerive eshte ne perputhje me Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".



4 | Page

Raport mbi modalitetet e bashkimit nepermet perthithjes te shoqerive
"CFO PHARMA" shpk dhe "OMEGA PHARMA GROUP" shpk

Kufizimet e audituesit gjate procesit te verifikimit te modaliteteve te bashkimit:

-Gjate procedurave te verifikimit te pasqyrave financiare te vitit te fundit 2015 per shoqerine "OMEGA PHARMA GROUP" shpk, u konstatua se ato nuk jane te audituara.

-Pasqyrat financiare te vitit 2015 te audituara te shoqerise perthithese "CFO PHARMA" shpk, jane riparaqitur ne pershtatje te Standarteve Nderkombetare te Kontabilitetit, te zbatueshme nga shoqeria e perthithur, me qellim bashkimin me perthithje me kompanine e perthithur. Por keto pasqyra te riparaqituara nuk jane certifikuar.

Une nuk mund te percaktoj me metoda te tjera alternative, nese do te ishte e nevojshme te behej ndonje rregullim per shkak te mungeses se certifikimit te te ketyreve pasqyrave te te dy shoqerive, gjate procesi i bashkimit te tepricave te llogarive te shoqerive qe bashkohen, si dhe nuk mund te percaktoj ne menyre te arsyeshme me saktesi efektet qe do te kishte sjelle ndonje rregullim i mundshem.

Eksperte Kontabël e Regjistruar

Nr lic143

Shpresa BREÇANI

Tiranë, më 26/10/ 2016



II. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SHOQËRITË.

-Shoqeria "CFO PHARMA" Sh.p.k, eshte nje shoqeri tregtare shqiptare e regjistruar në QKR datë 23.09.2002, me NIPT K22305002U, me seli në Tiranë, me Aksioner te vetem Z. Fatos Çausholli. Administrator i shoqerise eshte Z. Fatos Causholli. Kapitali Themeltar Fillestar i shoqerise eshte 18.000.000 leke.

-Shoqeria "OMEGA PHARMA GROUP" Sh.p.k., eshte nje shoqeri tregtare shqiptare e regjistruar në QKR, datë 24.03.2010, me seli në Tiranë, me ortak te vetem Z.Fatos Causholli. Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 900.000.000 leke dhe eshte i ndare ne 100 aksione ku 100 % te aksioneve zoterohen nga aksioneri Z. Fatos Causholli.

Per operacionin e bashkimit, Drejtimi i shoqerive ka hartuar projektin perkates ne te cilin eshte percaktuar qe Shoqeria "CFO PHARMA" shpk do te jete perthithese, ndersa shoqeria "OMEGA PHARMA GROUP" shpk do te quhet shoqeri e perthithur.

Shoqeria Perthithese: "CFO PHARMA" shpk

- Kapitali: 18.000.000 leke, i perbere nga 18.000 kuota me vlere 1.000 leke/secila
- Selia : Rruga e Duresit, Pallati Fratari, A/1, TIRANE
- Ortaket : Fatos Çausholli zoterues i 100% te kapitalit
-

Shoqeria e Perthithur: "OMEGA PHARMA GROUP" shpk

- Kapitali: 900.000.000 leke, i perbere nga 100 kuota me vlere 9.000.000 leke/secila
- Selia : Kthesa e Kamzes, perballe Casa Italia, TIRANE
- Ortaket : Fatos Çausholli zoterues i 100% te kapitalit



Raport mbi modalitetet e bashkimit nepermet perthithjes te shoqerive
"CFO PHARMA" shpk dhe "OMEGA PHARMA GROUP" shpk

III. PROCEDURAT E ANGASHIMIT PERFSHIJNE:

- Verifikimin e llogarive analitike si dhe kontrollin e llogarive specifike parashikuar nga Ligji Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"; Ligji Nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe kontabilistit te miratuar"; Ligji Nr.9228, date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
- Verifikimin e vleres dhe te dokumentacionit perkates lidhur me proceduren e bashkimit me perthithje, bazuar ne Pasqyrat Financiare.
- Organizimin e ketyre aktiveve, detyrimeve dhe kapitaleve, bazuar ne regjistrat kontabel.
- Verifikimin e Situates ekonomiko - financiare te shoqerive para momentit te bashkimit me perthithje.
- Pregatitjen e raportit te EKR-ve mbi verifikimin e procedurave per bashkimin me perthithje nga "CFO PHARMA" shpk te shoqerise "OMEGA PHARMA GROUP" shpk.

IV. PROJEKTI I BASHKIMIT

Qellimi i bashkimit eshte menaxhimi me i mire i aktivitetit ekonomik dhe financiar te shoqerise, zgjerimi i aktivitetit nepermjet perthithjes se aktivitetit te shoqerise kontribuese, duke realizuar ne kete menyre shtimin e produktit te ri, perballimin e konkurencave ne treg dhe per rrjedhoje rezultat me te mire te fitimit.

Bashkimi me perthithje i shoqerive nuk do te sjelle ndryshim per ortakun e vetem te shoqerise se perthithur pasi perthithet nga i njejti ortak, por ndryshimi vjen si rezultat i rritjes se vleres se ne raport me kuotat e tij te pandryshueshme mbi kapitalit e shoqerive qe bashkohen.

Ne projekt bashkim nuk eshte parashikuar nje ndarje apo vleresim i kuotave dhe per kete arsye, ne vleresimin tim raporti i ketyre kuotave percaktohet ne raport me vlerat e kapitalit rregjistruar ne QKR perpara ketij bashkimi.



Raport mbi modalitetet e bashkimit nepermet perthithjes te shoqerive
"CFO PHARMA" shpk dhe "OMEGA PHARMA GROUP" shpk

Ne kushtet kur paqyrat financiare te vitit 2015 te Omega Pharma Group shpk qe kane sherbuar si celje per pasqyrat e 9-mujorit jane te pacertifikuara si dhe paqyrat financiare te vitit 2015 te CFO Pharma (emri i meparshem AERD Farm) shpk te riparaqitura , qe kane sherbuar si celje per pasqyrat e 9-mujorit jane te pacertifikuara, vleresimi i ketyre kuotave eshte mbeshtetur teresisht ne regjistrimin e tyre ne QKR. Perderisa shoqeria nuk ka bere rivleresim te aktiveve apo detyrimeve, vleresimi i tregut per keto kuota nuk kerkuar ne projektmarreveshje.

Gjendja e kapitalit para bashkimit:

	CFO Pharma	Omega Pharma Group
Vlera e kapitalit te regjistruar	18,000,000	900,000,000
Nr I kuotave	18,000	100
Vlera per kuote	1,000	9,000,000

1 kuote e Omega Pharma Group kembetet me 9.000 kuota te CFO Pharma

Shoqeria e perthithur do te transferoje tek shoqeria perthithese "OMEGA PHARMA GROUP" shpk teresine e elementeve te aktivitetit dhe detyrimeve.

Shoqeria perthithese, pas bashkimit ka vleren e kapitalit te nenshkruar prej 918.000.000 leke, i ndare ne 18.000 kuota me vlere 51.000 leke/secila. Ortak i vetem i shoqerise eshte Fatos Çausholli, zoterues i 100% te kapitalit.

	Bashkimi me perthithje me shoqerive CFO PHARMA dhe Omega Pharma Group
Vlera e kapitalit	918,000,000
Nr I kuotave	18,000
Vlera per kuote	51,000

Une, pasi kam verifikuar te gjithe procesin dhe dokumentacionin e pershkruar me siper, kam paraqitur pozicionet e llogarive te Aktiveve, Detyrimeve dhe Kapitalit te pasqyrave financiare me 30.09.2016 te shoqerive qe marrin pjese ne bashkim.

Raport mbi modalitetet e bashkimit nepermet perthithjes te shoqerive
"CFO PHARMA" shpk dhe "OMEGA PHARMA GROUP" shpk

CFO PHARMA (AERD FARM)
L01529009P

Pasqyra individuale te pozicionit financiar

AKTIVE	9-Mujori 2016	VITI 2015	VITI 2014
<i>Aktive afat gjate</i>			
<i>Aktive afat gjate materiale</i>			
<i>Te tjera aktive afat gjate</i>			
Totali I Aktiveve Afatgjate	5,229,938	5,875,371	7,391,636
	5,229,938	5,875,371	7,391,636
<i>Aktive qarkulluese</i>			
<i>Inventari</i>	6,573,503	14,364,100	26,815,527
<i>Kliente (neto)</i>	8,021,890	31,431,069	39,235,693
<i>Kerkesa te tjera te arketueshme TVSH</i>	0	143,886	34,724
<i>Kerkesa te tjera te arketueshme (Tatim Fitimi)</i>	291,112	194,048	502,115
<i>Parapagime dhe shpenzime te shtyra</i>	2,337,545	49,932	48,213
<i>Likuiditete</i>	20,450,768	12,122,707	6,956,746
Totali I Aktiveve Qarkulluese	37,674,818	58,305,742	73,593,018
Totali I Aktiveve	42,904,756	64,181,113	80,984,654
	42,904,756	64,181,113	80,984,654
KAPITALET E VETA			
<i>Kapitali</i>	18,000,000	18,000,000	18,000,000
<i>Kapitali qe I perket aksionereve te shoqerise</i>			
<i>meme(perdoret vetem ne PF te konsoliduara)</i>			
<i>Rezerva te tjera</i>			
<i>Rezerva ligjore</i>	15,024,936	15,024,936	12,600,000
<i>Rezerva rivleresimi</i>	1,622,029	1,622,029	1,622,029
<i>Fitim (humbje) te pa shperndara</i>			
<i>Fitim (humbje) e vitit ushtrimor</i>	3,620,605	0	0
TOTALI I KAPITALIT	1,058,739	3,620,605	2,424,936
	39,326,309	38,267,570	34,646,965
DETYRIME			
<i>Detyrime afat gjate</i>			
<i>Hua afat gjate</i>			
<i>Grante dhe te ardhura te shtyra</i>	-	-	0
Totali I Detyrimeve Afatgjate	0	0	0
<i>Detyrime afat shkurter</i>			
<i>Llogari te pagueshme (furniture)</i>			
<i>Kesti afat shkurter i huase afat gjate</i>	817,201	20,402,920	37,000,105
<i>Hua afat shkurter</i>			0
<i>Te drejta dhe detyrime (dividenti)</i>	2,496,561	5,200,135	9,069,164
<i>punonjesve dhe tatimoreve</i>			0
<i>Provizionet afatshkurtra</i>	264,685	292,989	257,088
<i>Parapagimet e Arketuara</i>			
Totali I Detyrimeve Afatshkurtra	3,578,447	25,913,543	46,337,688
	3,578,447	25,913,543	46,337,688
Totali I Detyrimeve	3,578,447	25,913,543	46,337,688
Totali I Kapitalit dhe I detyrimeve	42,904,756	64,181,113	80,984,653
	42,904,756	64,181,113	80,984,653

Raport mbi modalitetet e bashkimit nepermet perthithjes te shoqerive
"CFO PHARMA" shpk dhe "OMEGA PHARMA GROUP" shpk

"OMEGA PHARMA GROUP" sh.p.k
L01529009P

Pasqyra individuale te pozicionit financiar

AKTIVE	9-Mujori 2016	VITI 2015	VITI 2014
<i>Aktive afat gjate</i>			
<i>Aktive afat gjate materiale</i>			
<i>Te tjera aktive afat gjate</i>			
Totali I Aktiveve Afatgjate	702,200,335	591,080,036	551,984,536
Totali I Aktiveve Afatgjate	702,200,335	591,080,036	551,984,536
<i>Aktive qarkulluese</i>			
<i>Inventari</i>			
<i>Kliente (neto)</i>	567,664,780	1,048,678,606.67	1,238,817,763
<i>Kerkesa te tjera te arketueshme(TVSH)</i>	543,167,908	367,286,129	398,618,647
	6,854,831	0	16,294,671
<i>Kerkesa te tjera te arketueshme(Tatim Fitimi)</i>	6,698,370	34,959,194	34,959,194
<i>Parapagime dhe shpenzime te shtyra</i>	62,560,905	131,068,650	214,600,000
<i>Likuiditete</i>	78,102,567	37,741,782	12,729,586
Totali I Aktiveve Qarkulluese	1,265,049,361	1,619,734,362	1,916,019,861
Totali I Aktiveve	1,967,249,696	2,210,814,398	2,468,004,397

KAPITALET E VETA

<i>Kapitali</i>	900,000,000	900,000,000	869,000,000
<i>Kapitali qe I perket aksionereve te shoqerise meme(perdoret vetem ne PF te konsoliduara)</i>			
<i>Rezerva te tjera</i>			
<i>Rezerva ligjore</i>			
<i>Rezerva rivleresimi</i>	40,000,000	40,000,000	9,038,244
<i>Fitim (humbje) te pa shperndara</i>	111,512,797		
<i>Fitim (humbje) e vitit ushtrimor</i>	82,856,277	111,512,797	63,161,555
TOTALI I KAPITALIT	1,134,369,073	1,051,512,797	941,199,799
DETYRIME			
<i>Detyrime afat gjate</i>			
<i>Hua afat gjate</i>			
<i>Grante dhe te ardhura te shtyra</i>	171,600,556	222,965,535	288,768,364
Totali I Detyrimeve Afatgjate	171,600,556	222,965,535	288,768,364
<i>Detyrime afat shkurter</i>			
<i>Llogari te pagueshme (furniture)</i>			
<i>Kesti afat shkurter i huase afat gjate</i>	648,453,380	920,394,887	940,336,951
<i>Hua afat shkurter</i>			13,291,685
<i>Te drejta dhe detyrime (dividenti)</i>		343,203	280,262,437
<i>punonjesve dhe tatimoreve</i>	1,269,787	1,269,787	1,269,787
<i>Provizionet afatshkurtra</i>	11,556,900	14,328,189	2,875,374
<i>Parapagimet e Arketuara</i>			
Totali I Detyrimeve Afatshkurtra	661,280,067	936,336,066	1,238,036,234
Totali I Detyrimeve	832,880,623	1,159,301,601	1,526,804,598
Totali I Kapitalit dhe I detyrimeve	1,967,249,696	2,210,814,398	2,468,004,397

Sipas mendimit tim: Ne kete bashkim zbatohen me se miri kerkesat e nenit 217, pika 2, germa a, b, c, ku raporti i kembimit te kuotave eshte i drejte dhe i arsyeshem.

Shoqeria perfituese e kontributeve, ose shoqeria perthithese do te ruaje emrin "**CFO PHARMA**" shpk ne perfundim te ketij procesi.

Selia e shoqerise perfituese te kontributeve do te jete ne adresen: Rruga e Duresit, Pallati Fratari, A/1, TIRANE.

Te drejtat dhe detyrimet e shoqerise te perthithur "**OMEGA PHARMA GROUP**" shpk do ti kalojne shoqerise perthithese "**CFO PHARMA**" shpk, pas perfundimit te operacionit te bashkimit te shoqerive sipas nenit 219 dhe 220 te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Shoqeria "**CFO PHARMA**" sh.p.k. nuk merr persiper gjoba apo penalitete te cilat mund ti vihen shoqerise "**Omega Pharma Group**" sh.p.k. pas ketij bashkimi.

Te gjitha ambjentet te perdorura per tregtim me NIPT ne emer te "**Omega Pharma Group**"sh.p.k. i kalojne shoqerise "**CFO PHARMA**" sh.p.k.. Gjithashtu dhe Licencat profesionale (QKL) te cilat jane ne emer te "**Omega Pharma Group**"sh.p.k. ne cdo adrese respektive i kalojne shoqerise "**CFO PHARMA**" sh.p.k. Gjendja inventariale e mallit, i cili ndodhet ne ambjentet e licencuara prane QKL-se te "**Omega Pharma Group**"sh.p.k. i kalon ne pronesi te "**CFO PHARMA**" sh.p.k. pas ketij bashkimi.

V. METODAT E PERDORURA PER BASHKIMIN E DY SHOQERIVE.

Ne kuadrin e ketij operacioni, bashkimi i dy shoqerive ne nje te vetme, ka si qellim qe kapitali i nenshkruar i dy shoqerive te bashkohet ne nje, sipas raportit te zmadhimit e percaktuar ne nenin 219 te Ligjit Nr.9901,date 14.04.2008.

Ne rastin e ketij bashkimi, kapitali i shoqerise perthithese eshte rritur, ku vlere e zmadhimit njoftohet se bashku me bashkimin, duke perthithur te gjitha aktivet e detyrimet e shoqerise. Ky transferim ka pasoja si ne marredheniet ndermjet shoqerive, ashtu edhe tek palet e treta.

Shoqeria "**CFO PHARMA**" shpk gezon frutet e kontributit te shoqerise "**OMEGA PHARMA GROUP**" shpk, duke filluar nga data e realizimit te bashkimit ne fjale.

Metoda e bashkimit rrit vlerat e pjeseve te kapitalit, te cilat jane te drejta dhe te arsyeshme.



Keshtu, para fillimit te procedurave te bashkimit, kapitali themeltar i shoqerise "OMEGA PHARMA GROUP" shpk eshte **900.000.000 leke**, i ndare ne **100 kuota me vlere 9.000.000 leke/secila** dhe kapitali i Shoqerise "CFO PHARMA" shpk eshte **18.000.000 leke**, i ndare ne **18.000 kuota me vlere 1.000 leke/secila**.

Pas perfundimit te procedurave te bashkimit, sipas vleresimit te ketyre kuotave, kapitali i shoqerise "CFO PHARMA" shpk do te jete **918.000.000 leke**, i perbere nga **18.000 kuota** me vlere **51.000 leke/ secila**, te zoteruar nga ortaku i vetem Fatos Çausholli zoterues i 100% te kapitalit. Raporti i kembimit te kuotave eshte 1 kuote e CFO Pharma shpk kembehet me 9.000 kuota te Omega Pharma Group shpk.

Emri i shoqerise pas perfundimit te bashkimit do te jete "CFO PHARMA" shpk.

Ky operacion bashkimi gjykoj se nuk do te kete veshtersi, as ndonje avantazh te vecante. Ai nenshkruhet dhe hartohet me miratim nga Asambleja e ortakeve te seciles prej shoqerive.

VI. VEPRIMET KONTABILE PER PARAQITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE TE SHOQERISE "CFO PHARMA" shpk (shoqeria perthithes)

Per te realizuar bashkimin me perthithje te shoqerive CFO PHARMA shpk dhe OMEGA PHARMA GROUP shpk kryhet procesi i konsolidimit te tepricave te llogarive ne date 30.09.2016.

Kapitalit Aksioner i shoqerise "CFO PHARMA" shpk do te shtohet nga 18.000.000 leke ne 918.000.000 leke.

Pasqyrat financiare pas bashkimit si pjese perberese e ketij raporti paraqiten ne tabelen si me poshte vijon:



Raport mbi modalitetet e bashkimit nepermet perthithjes te shoqerive

"CFO PHARMA" shpk dhe "OMEGA PHARMA GROUP" shpk

VII. PASQYRAT FINANCIARE PAS BASHKIMIT

Pasqyra individuale te pozicionit financiar	CFO PHARMA	OMEGA PHARMA GROUP	BASHKIMI I SHOQERIVE
	9-Mujori 2016	9-Mujori 2016	9-Mujori 2016
<u>AKTIVE</u>			
<u>Aktive afat gjate</u>			
Aktive afat gjate materiale			
Te tjera aktive afat gjate	5,229,938	702,200,335	707,430,273
Totali I Aktiveve Afatgjate	5,229,938	702,200,335	707,430,273
<u>Aktive qarkulluese</u>			
Inventari	6,573,503	555,189,954	561,763,457
Kliente (neto)	8,021,890	543,167,908	551,189,798
Kerkesa te tjera te arketueshme(TVSH)	-	6,854,831	6,854,831
Kerkesa te tjera te arketueshme(Tatim Fitimi)	291,112	6,698,370	6,989,482
Parapagime dhe shpenzime te shytyra	2,337,545	62,560,905	64,898,450
Likuiditete	20,450,768	78,102,567	98,553,335
Totali I Aktiveve Qarkulluese	37,674,818	1,252,574,535	1,290,249,353
Totali I Aktiveve	42,904,756	1,954,774,870	1,997,679,626
<u>KAPITALET E VETA</u>			
Kapitali	18,000,000	900,000,000	918,000,000
Kapitali qe I perket aksionereve te shoqerise meme(perdoret vetem ne PF te konsoliduara)			15,024,936
Rezerva te tjera	15,024,936		41,622,029
Rezerva ligjore	1,622,029	40,000,000	
Rezerva rivleresimi			
Fitim (humbje) te pa shperndara	3,620,605	111,512,797	115,133,402
Fitim (humbje) e vitit ushtrimor	1,058,739	30,501,564	31,560,303
TOTALI I KAPITALIT	39,326,309	1,082,014,361	1,121,340,670
<u>DETYRIME</u>			
<u>Detyrime afat gjate</u>			
Hua afat gjate	-	171,600,556	171,600,556
Grante dhe te ardhura te shytyra	-		-
Totali I Detyrimeve Afatgjate	0	171,600,556	171,600,556
<u>Detyrime afat shkurter</u>			
Llogari te pagueshme (furniture)	817,201	688,333,266	689,150,467
Kesti afat shkurter i huase afat gjate			2,496,561
Hua afat shkurter	2,496,561	-	
Te drejta dhe detyrime (dividenti)		1,269,787	1,269,787
dhe tatimoreve	264,685	11,556,900	11,821,585
Provizionet afatshkurtra			
Parapagimet e Arketuara	-		
Totali I Detyrimeve Afatshkurtra	3,578,447	701,159,953	704,738,400
Totali I Detyrimeve	3,578,447	872,760,509	876,338,956
Totali I Kapitalit dhe I detyrimeve	42,904,756	1,954,774,870	1,997,679,626



Raport mbi modalitetet e bashkimit nepermet perthithjes te shoqerive

"CFO PHARMA" shpk dhe "OMEGA PHARMA GROUP" shpk

Pasqyra e te ardhurave individuale	CFO PHARMA	OMEGA PHARMA GROUP	BASHKIMI I SHOQERIVE
	9-Mujori 2016	9-Mujori 2016	9-Mujori 2016
Shitje neto	18,278,429	2,399,552,126	2,417,830,555
Te ardhura tjera	<u>18,278,429</u>	<u>2,399,552,126</u>	<u>2,417,830,555</u>
Shpenzime operacionale	(13,539,577)	(2,240,478,176)	(2,254,017,753)
Kosto mallit(fat vlere 0)	-		0
Paga sigurime shoqerore dhe shendetesore	(2,054,862)	(69,626,302)	(71,681,164)
Amortizimi	(645,433)	(14,339,513)	(14,984,946)
Te tjera shpenzime	<u>(759,839)</u>	<u>(62,938,167)</u>	<u>(63,698,006)</u>
	<u>(16,999,711)</u>	<u>-2,387,382,158</u>	<u>-2,404,381,869</u>
Rezultati nga aktiviteti kryesor	<u>1,278,718</u>	<u>12,169,968</u>	<u>13,448,686</u>
Shpenzime per interesa huaje		(9,796,394)	(9,796,394)
Humbje nga diferenca konvertimi			
Te ardhura (shpenzime) financiare	(33,143)	33,510,619	33,510,619
Shpenzime financiare- neto	<u>(33,143)</u>	<u>23,714,225</u>	<u>23,714,225</u>
Fitimi përpara tatimit	1,245,575	35,884,193	37,129,768
Shpenzime te pa zbritshme			
Tatim fitimi	186,836	5,382,629	5,569,465
Fitimi (humbje) neto për periudhën	<u>1,058,739</u>	<u>30,501,564</u>	<u>31,560,303</u>
Diferenca konvertimi nga operacionet jashtë njesisë			
Rivlerësimë të pasurive të paluajtshme			
Tatim mbi të ardhurat gjithëpërfshirëse			
Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse (neto nga tatimi)	1,058,739	3,620,605	2,424,936
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën	<u>1,058,739</u>	<u>3,620,605</u>	<u>2,424,936</u>

Raport mbi modalitetet e bashkimit nepermet perthithjes te shoqerive

"CFO PHARMA" shpk dhe "OMEGA PHARMA GROUP" shpk

Pasqyra e Flukseve Monetare individuale			
	CFO PHARMA	OMEGA PHARMA	BASHKIMI
	9-Mujori 2016	9-Mujori 2016	9-Mujori 2016
Pasqyra e fluksit monetar - Metoda direkte			
Fluksi I parave nga veprimtarite e shfrytezimit			
1 Parate e arketuara nga klientet	41,687,608	1,801,499,992	1,843,187,600
2 Parate e paguara ndaj furnitoreve dhe punonjesve	(30,338,930)	(1,574,518,022)	(1,604,856,952)
3 Parate te ardhura/paguara nga veprimtarite			0
4 Interes I paguar	(33,143)	(9,796,394)	(9,829,537)
5 Tatim mbi fitimin i paguar	(283,900)		(283,900)
A Shuma (Para neto nga veprimtarite e shfrytezimit)	11,031,636	217,185,576	228,217,212
Fluksi I parave nga veprimtarite investuese			
1 Pagese per blerje te kompanive te kontrolluara			
2 Pagese per blerje e aktiveve aftagjate materiale	-	(125,459,812)	(125,459,812)
3 Arketimet nga shitja e pajisjeve			
4 Interes I arketuar			
5 Dividentet e Arketuar			
B Para neto te perdorura ne veprimtarite	0	(125,459,812)	(125,459,812)
Fluksi monetar nga aktivitetet financiare			
1 Arketime nga emetimi I kapitalit aksionar			
2 Arketime nga huamarrje afatgjate			
3 Pagesat e detyrimeve te pagesave te qirave financiare	(2,703,574)	(51,364,979)	(54,068,553)
4 Dividente te paguar			
C Paraja neto e perdorur ne veprimtarite financiare	(2,703,574)	(51,364,979)	(54,068,553)
Pagesa te pacaktuara			
Rritja / Renia neto e mjeteve monetare	8,328,062	40,360,785	48,688,846
Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel	12,122,707	37,741,782	49,864,489
Mjetet monetare ne fund te perudhes kontabel	20,450,769	78,102,567	98,553,335



Raport mbi modalitetet e bashkimit nepermet perthithjes te shoqerive
"CFO PHARMA" shpk dhe "OMEGA PHARMA GROUP" shpk

Pasqyra individuale e ndryshimit te Kapitalit

Kapitali aksionar qe i perket aksionareve te shoqerise me me

	Kapitali aksionar	Primi i aksionit e thesarit	Aksionet e ligjore	Rezerva statutore dhe ligjore	Rezerva te konvertimit te monedhave te huaja	Fitimi i pasqerndare	Rezerva te tjera	Shuma te parashikuara per rreziqe	Totali
Pozicioni me 30 SHTATOR 2016 CFO	18,000,000	-	-	1,622,029		3,620,605	15,024,936	-	38,267,570
Pozicioni me 31 SHTATOR 2016 OMEGA	900,000,000			40,000,000		111,512,797			1,051,512,797
Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabel									
Pozicioni i rregulluar									
Fitimi neto i periudhes kontabel 9-mujor CFO						1,068,739			1,058,739
Fitimi neto i periudhes kontabel 9-mujor OMEGA						30,501,564			30,501,564
Efekte te ndrysh te kurseve te kemb gjate konsol									-
Dividentet e paguar/deklaruar									-
Transferime ne rezerven e detyr ligjore									-
Transferime ne rezerven e detyr statut									-
Transferime ne rezerva te tjera									-
Emetimi i kapitalit aksionar									-
Rezerva rivleresimi i AAGI									-
Transferime ne detyrimet									-
Bleje aksionesh thesari									-
Terheqje kapitali per zvogelim									-
Pozicioni me 30 SHTATOR 2015 i shoqerive te bashkuara	918,000,000	-	-	41,622,029		146,693,705	15,024,936	-	1,121,340,670

VIII. FUNKSIONI I SHOQERISE PERTHITHESE.

Shoqeria "CFO PHARMA" shpk do te vazhdoje te funksionoj sipas te njejtës metode organizimi dhe drejtimi qe ka aktualisht, duke funksionuar me nje administrator Z. Fatos Çausholli.

Veprimtaria e shoqerise do te jete: *Import - eksport medikamente e lende te para, e te licensuar nga organet e tjera kompetente ne rastet kur kerkohet. Tregtim me shumice e pakice te artikujve farmaceutik. Import eksport paisjesh mjeksore, reagenteve dhe kiteve, servis paisjesh mjeksore dhe mirmbajtje*

Ortaku i vete i saj eshte Fatos Çausholli zoterues i 100% te kapitalit.

Ne vijim te procedurave te kryera une konstatova se:

- Vendimi i asamblese se aksionereve te shoqerise qe bashkohen, eshte i sakte dhe ne perputhje me kornizen ligjore
- Bashkimi me perthithje i shoqerise "OMEGA PHARMA GROUP" shpk nga shoqeria "CFO PHARMA" shpk po kryhet ne kushtet e percaktuara ne Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".
- Bashkimi me perthithje i shoqerise "OMEGA PHARMA GROUP" shpk nga shoqeria "CFO PHARMA" shpk behet duke siguruar vazhdimesine ekonomike te veprimtarise, ne kushte te ngjashme si perpara bashkimit. Bashkimi kryhet pas marrjes se Vendimit te asamblese se ortakeve repsektive te te dyja shoqerive qe bashkohen.



Raport mbi modalitetet e bashkimit nepermet perthithjes te shoqerive
"CFO PHARMA" shpk dhe "OMEGA PHARMA GROUP" shpk

IX. KONKLUZIONE PERFUNDIMTARE.

Si perfundim vertetoj se:

- Bashkimi i dy shoqerive eshte ne perputhje me Ligjin nr.9901 dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare";
- Raporti i kembimit te kuotave eshte i drejte dhe i arsyeshem, i kryer me kerkesat e nenit 217, pika 2 e ligjit Nr 9901, dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare";
- Kapitali i nenshkruar rritet ne shoqerine perthithese "CFO PHARMA" shpk nga 18.000.000 leke shkon ne 918.000.000 leke, i perbere nga 18.000 kuota me vlere 51.000 leke;
- Ortaku i vetem i shoqerise "CFO PHARMA" shpk eshte FATOS ÇAUSHOLLI, zoterues i 100% te kuotave;
- Shoqeria "OMEGA PHARMA GROUP" shpk priset pa likujdim ne perputhje me ligjin Nr. 9901, dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare";
- Bashkimi i elementeve te pasurise, aktive dhe detyrimeve, ne shoqerine perthithese do te behet me inventarizimin fizik te tyre, ne momentin e bashkimit.

Tiranë, më 26/10/2016

Eksperte Kontabël e Regjistruar

Shpresa BREÇANI

